
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo  Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

<b>Datë/a:</b>	10.05.2020
<b>Për/ Za/ To:</b>	"Office I Kosova"
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 07.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Office I Kosova", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me libra për Bibliotekën "Hivzi Sylejmani", me numër të prokurimit: 616 20 1331 121 nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga OE-ik "Office I Kosova" e dates 07.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me libra për Bibliotekën "Hivzi Sylejmani", me numër të prokurimit: 616 20 1331 121 , kundër Njoftimit për kontratë te AK -së, të datës 13.04.2020.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi i AK datë: 14.03.2020 dhe modifikimi i kërkesës nga publikimi i formularit të gabimeve të datës 15.04.2020.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit ta vazhdoj sipas kërkesave të njejta nga njoftimi i dates 13.04.2020 dhe Njoftimit për korigjimin e gabimeve të datës 15.04.2020.
4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 11.05.2020 ka shqyrtuar kërkesën dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi 1 se Autoriteti Kontraktues ka paraqitur kërkesa diskriminuese është i pa bazuar pasi që pas vërejtjeve lidhur me kërkesat teknike profesionale është bërë korigjimi i të njejtit (kriteri për dëshmi që ju e keni paraqitur në kërkesë nuk ekziston pasi që është ndryshuar) dhe duke u bazuar në rrethanat e krijuara nga pandemia është modifikuar kërkesa për marrëveshjet origjinale dhe është përcaktuar se në rrethanat aktuale mjafton çfarëdo kopje e marrëveshjeve apo vetëm konfirmimi i shtëpive botuese që pajtohet të furnizoj tenderuesin me librat që i boton sipas të drejtave autoriale. Kërkesa juaj për largimin e kriterit për marrëveshje me shtëpitë botuese si që e dini edhe ju është në kundërshtim me të drejtën e autorit dhe të shtëpive botuese që e gëzojnë të drejtën e botimit të librave të të njejtit. Për të mbrojtur këtë të drejtë është paraqitur kërkesa për marrëveshje apo çfarëdo konfirmimi i të njejtës me botuesit, pasi që në të kaluarën janë paraqitur keqpërdorime të kësaj të drejte dhe shpesh herë janë paraqitur edhe marrëveshje të dyshimta apo të pa sakta nga disa botues dhe për këtë arsye në tender janë dhënë edhe emrat e shtëpive botuese sipas titujëve të librave. Lidhur me këtë iu sqarojmë se kemi pasë raste kur autorët na kanë paditur ne dhe botuesit për mos respektim të drejtës autoriale dhe që atëherë kemi konstatuar se e vetmja mundësi për ti ikur një shkelje të tillë është marrëveshja me botuesit dhe kjo nuk ka të bëjë aspak me favorizim apo diskriminim të ndonjë OE-ik të interesuar për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit. I vetmi “diskriminim” që ju mund ta trajtoni si të tillë është fakti se ne kemi paraqitur për çdo titull të librit edhe shtëpinë botuese që ka të drejtën e botimit dhe kjo natyrisht pamundëson veprimet si në vitin paraprak që në marrëveshje me ndonjë prej tyre të paraqiten edhe titujt që nuk janë botime të të njejtave.

-Pretendimi juaj se tenderi është parapërgatitur është një tendencë e juaja për të ndryshuar kriteret e bazuara të tenderit sepse kërkesa për marrëveshje me shtëpitë botuese nuk e favorizon as dëmton askend, pasi që secili OE-ik mund të blejë librat nga çdo shtëpi botuese dhe për atë që sa ne kemi njohuri asnjë shtëpi botuese nuk ka asnjë OE-ik të kontraktuar si të vetmin për shitjen e botimeve të veta dhe sipas kësaj asnjë tenderues nuk e ka ekskluzivitetin për shitje e librave të ndonjë shtëpie botuese duke eliminuar të drejtën e marrëveshjeve me tenderuesit tjerë. Ato shkresa që i keni dorëzuar nga disa botues janë plotësisht të pa bazuara, pasi që asnjë prej tyre nuk ka të drejtë që ti jap ekskluzivitetin e shitjes asnjë OE-ik të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet apo në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me shitjen e librave të tyre. Arsyet që janë deklaruar në shkresat e tyre lidhur me atë se kanë një marrëveshje me një OE-ik të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet janë të pa bazuara, pasi që jemi të sigurtë se nuk mund ti jepet ky ekskluzivitet askujt. Edhe më absurd është arsyetimi i një botuesi se nuk mund të tubohet Bordi në kushtet e pandemisë, pasi që shume takime të nivele të ndryshme qeveritare dhe ndërkombëtare mbahen në formë virtuale dhe në këtë mënyrë sjellin Vendime të rëndësishme e në këtë formë mund të vendos pa asnjë problem edhe ai Bord. Kjo është e vërteta sipas të cilës duhet vepruar, por nëse ka arsye tjera për mos pajtimet për marrëveshje, atëherë ato nuk janë çështje që mund të rregullohen me procedura të



prokurimit, por rregullohen me mirëbesimin dhe korektësinë reciproke në mes jush dhe shtëpive botuese.

-Lidhur me pretendimin se nuk i jemi përgjegjur kërkesës tuaj për sqarime ju sqarojme se në Platformën elektronike e as në emailin tonë zyrtar nuk ka asnjë kërkesë tauajën që mban datën 30.04.2020. Të gjitha kërkesat për sqarime në adresën tonë kanë të bëjnë me datat 14.04.2020 (kërkesa e një OE-ik tjetër), datën 15.04.2020 (kërkesa juaj) dhe me datë 29.04.2020 (kërkesa e një OE-ik tjetër) dhe në të njejtat jemi përgjegjur. Vlen të theksojmë se bazuar në kërkesat e datave 14.04.2020 dhe 15.04.2020 dhe vërejtjet e mija pas publikimit të njoftimit për kontratë, duke u bazuar në rrethanat e shkaktuara nga pandemia e korona virusit është bërë korigjimi i njoftimit për kontratë me datë 15.04.2020, nëpërmes të të cilit është modifikuar dëshmia për pikën 9.2 të FDT-së dhe është formuluar si vijon: Kopjet e marreveshjeve dhe konfirmimet nëpërmes adresave elektronike nga botuesit (bazuar në rrethanat aktuale të pandemisë). Pra na kjo shihet se kemi respektuar kërkesat tuaja dhe të OE-ik tjerë të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet.

Bazuar në sqarimet e mësipërme konstatoj se kërkesat e Autoritetit Kontraktues janë në harmoni me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik dhe me dispozitat tjera që rregullojnë fushën e veprimtarisë që përfshin aktiviteti konkret.

Nga të gjitha konstatimet paraprake u vendos si në dispozitiv të Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij Vendimi.**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

